



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/04-14865/20 dt. 25.01.2021, të investitorit OJQ. “Vier Pfofen Kosova”, me seli në Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar Afrim Mahmuti, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat “Qendrat ambientale jo-fitim prurëse për edukimin rreth mirëqenies së kafshëve” dhe “Depo e ushqimit”, e ndërtuar në kuadër të kompleksit “Strehimorja e arinjve” në fshatin Novosellë, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 04.03.2021 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit OJQ-së “Vier Pfofen Kosova” me seli në Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar Afrim Mahmuti, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-14865/21 dt. 25.01.2021, për përdorimin e ndërtesave “Qendra ambientale jofitimprurëse për edukimin rreth mirëqenies së kafshëve” dhe “Depo e ushqimit”, e ndërtuar në kuadër të parcelës kadastrale 36-0, Zona Kadastrale Novo sellë, sipas Vendimit 05Nr.351-311558 dt. 08.05.2017 për lejimin e ndërtimit të ndërtesave si dhe Konkluzionit mbi ndryshimin e pjesës grafike-zhvendosjen e ndërtesës në kuadër të parcelës me numër 05Nr.351-311558 dt. 07.06.2017.

II. Ndërtesat, mund të përdoren, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-311558 dt. 08.05.2017, Konkluzionit mbi ndryshimin e pjesës grafike-zhvendosjen e ndërtesës në kuadër të parcelës me numër 05Nr.351-311558 dt. 07.06.2017, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

III. Ndërtesat mund të përdoren nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Certificate shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

V. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas shtojca 6 e Udhëzimit Administrativ MMPH. Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronari OJQ-së “Vier Pfofen Kosova” me seli në Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar Afrim Mahmuti, më kërkesën me 05 Nr. 391/02-14865/21 dt. 25.01.2021, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesat “Qendra ambientale jofitimprurëse për edukimin rreth

të kësaj certifikate.

Paraprakisht Drejtoria e Inspektionit-Sektorit i ndërtimit i Komunës së Prishtinës përmes shkresës zyrtare “Akt Përcjellës me referencë 09 Nr. 391/01-223895/20 dt. 22.01.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportin e Inspektimit final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Me kërkesë, kërkuarit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e udhëzimit administrativ MMPH Nr. 05/2017 për bikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit shtojca 2 dhe 4/a deri 4/f
- Vendimin nr. 05 Nr.351-311558 dt. 08.05.2017 për lejimin e ndërtimit të ndërtesave “Qendra ambientale jofitimprurëse për edukimin rreth mirëqenies së kafshëve” dhe “Depo e ushqimit”, me investitor OJQ-së “Vier Pfofen Kosova” me seli në Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar Afrim Mahmuti e ndërtuar në kuadër parcelës kadastrale 36-0, Zona Kadastrale Novosellë .
- Konkluzionin 05 Nr.351-311558 dt. 07.06.2017 mbi ndryshimin e pozitës së ndërtesave të planifikuara me Lejen ndërtimore përkatësisht zhvendosjen e ndërtesës sipas koordinatave – ripozicionimin në distancë 6.50 m’ në drejtimin veriperëndimor.
- Dispozita urbanistike e objektit me parcelën kadastrale në sistemin Kosovaref01.
- Konstatim mbi caktimin e pikave të objektit me nr. të referencës 05-945/01-011655/17 të dt.06.07.2017.
- Aktvendimin numër 05 Nr. 351-311558 dt. 14.04.2017, mbi caktimin e taksës Administrative për lejen e ndërtimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Dëshmi mbi pagesën e taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes, Ilir Meleqi, IDN. udhëheqës i vend ndërtimit, Benjamin Kabashi, MSc. mbikëqyrës për arkitekturë, Sabahidin Veseli, IND. mbikëqyrës për Strukturë, Becir Zecirovic, IDH. mbikëqyrës për Hidro-Instalime, Ibrahim Elezi, IDE. Mbikëqyrës për Instalime elektrike, Vehbi Avdullahaj, IDM. Mbikëqyrës për Instalime makinerike, Ferid Ahmet, gjeodet.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Protokollin e miratuar për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Fletë pagesat për pagesën e kompensimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportin e Komisionit të Inspektimit Final të Inspektionit të ndërtimit të ndërtesës dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr. 391/02-14865/21 dt. 25.01.2021 ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerike, mbrojtjes nga zjarri dhe punëve zeytare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen ndërtimore 05 Nr. 351-311558 dt. 08.05.2017, Konkluzionit mbi ndryshimin e pjesës grafike-zhvendosjen e ndërtesës në kuadër të parcelës me numër 05Nr.351-311558 dt. 07.06.2017, mbi miratimin e ndryshimeve në

projektin kryesor. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Në Raportin e Inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektorit i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në objekt janë të përfunduara. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Inspektionit të Ndërtimit.

Kërkesat e Vendimit Lejes Ndërtimore janë zbatuar,

Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,

Masat për kursim të energjisë janë zbatuar.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesat “Qendra ambientale jofitimprurëse për edukimin rreth mirëqenies së kafshëve” dhe “Depo e ushqimit”, mund të përdoren/shfrytëzohen, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këto ndërtesa.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINË
05 NR. 391/02-14865/21 DT. 04.03.2021**

Zyrtari:

Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit

Mimoza Berisha Prestreshi



